



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

THIRRJE PËR APLIKIM PËR BURSË STUDIMI NË PROGRAMET BACHELOR DHE MASTER NË UNIVERSITETIN ADA AZERBAJXHAN

Bursa Ndërkombëtare e emëruar pas Alimardan bay Topchubashov është e hapur për të gjithë aplikantët ndërkombëtarë Bachelor dhe Master që janë pranuar në një nga shkollat e Universitetit ADA. Bursa është e rinovueshme çdo semestër për kohëzgjatjen e studimeve të studentëve, kur plotësohen disa kriteret sipas disponueshmërisë së fondeve.

Të interesuarit duhet të dorëzojnë aplikimet e tyre sipas kriterëve të mëposhtme përmes aplikimit online në ëebfaqen zyrtare të Universitetit ADA në Azerbajxhan në e-adresat:

www.ada.edu.az/apply

portal.edu.az/

BURSA MBULON:

1. Tarifën e shkollimit - përfituesit e bursës kanë të drejtë të marrin 100% mbulin të pagesës së shkollimit për semestrin e parë të studimeve të tyre.
2. Tarifën e akomodimit - përfituesit e bursës kanë të drejtë të akomodohen falas sipas zgjedhjes së Universitetit për semestrin e parë të studimeve të tyre.
3. Pagë mujore (Stipend) - përfituesit e bursës kanë të drejtë të marrin 400 AZN (215,38 Euro) pagë mujore për muajt Shtator - Maj.
4. Sigurim mjekësor - përfituesit e bursës kanë të drejtë të marrin një sigurim mjekësor vjetor.

SI TË MBAJNË BURSËN:

Studentët që marrin në semestër notë mesatare (GPA) prej 2.5 ose më të lartë në programet bachelor dhe 3.00 ose më të lartë në programet master ruajnë bursën. Studentët që ndjekin një nivel (kurse) bazë duhet ta kalojnë me sukses atë.

BURSA NUK MBULON:

1. Tarifën studentore - përfituesit e bursës duhet të mbulojnë tarifën studentore prej 375 AZN (201,98 Euro) në bazë semestrale.
2. Shpenzime të tjera - përfituesit e bursës duhet të mbulojnë kostot që lidhen me materialet e kursit, fluturimet, transportin etj.
3. Semestrin veror - përfituesit e bursës duhet të mbulojnë kostot e kurseve të marra në semestrin veror.

Studentët që shkelin një herë Kodin e Nderit të Universitetit ADA dhe Kodin e Sjelljes së Studentëve nuk do të kenë të drejtë për bursë për pjesën e mbetur të qëndrimit të tyre në Universitet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

Programet e ofruara në kuadër të bursave ndërkombëtare të universitetit ADA

BACHELOR:

- Shkenca Kompjuterike;
- Inxhinieri Kompjuterike;
- Teknologji Informacioni;
- Matematikë;
- Inxhinieri Elektrike dhe Elektronike;
- Administrim Biznesi;
- Ekonomik;
- Financë;
- Komunikim dhe Media Digjitale;
- Studime Ndërkombëtare;
- Çështjet Publike;
- Shkenca e Kafshëve;
- Shkenca Bujqësore;
- Arkitekturë;
- Dizajn i Brendshëm.

MASTER:

- Diplomaci dhe Çështjet Ndërkombëtare;
- Administratë Publike;
- Mësimdhënia dhe të Nxënit;
- Menaxhim Arsimor;
- Menaxhim i Sistemit Bujqësor dhe Ushqimor;
- Menaxhim i Burimeve Njerëzore;
- Master në Administrim Biznesi (MBA);
- Master në Financë (*diplomë duale me Universitetin MGIMO në Rusi*);
- Menaxhim Global dhe Politika (*diplomë duale me Universitetin Luiss në Itali*);
- MS në Shkenca Kompjuterike dhe Analiza të të Dhënave (*diplomë duale me Universitetin George Washington në SHBA*);
- MS në Inxhinieri Kompjuterike dhe Llogaritje me Performancë të Lartë (*diplomë duale me Universitetin George Washington në SHBA*);
- MS në Inxhinieri Elektrike dhe Energjetike (*diplomë duale me Universitetin George Washington në SHBA*);

LISTA E DOKUMENTEVE PËR APLIKIMIN PËR BURSË NË BACHELOR:

1. Rezyme ose CV;
2. Foto e kohëve të fundit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

3. Pasaportë ndërkombëtare;
4. Diploma zyrtare e shkollës së mesme dhe lista e notave të shkollës së mesme;
5. Deklarata e qëllimit;
6. Rezultati i testit të anglishtes (opsionale).

Afati i aplikimit të bursave: 1 prill 2024

Afati i vonë i aplikimit: 1 gusht 2024.

LISTA E DOKUMENTEVE PËR APLIKIMIN PËR BURSË NË MASTER:

1. Rezyme ose CV;
2. Foto e kohëve të fundit;
3. Pasaportë ndërkombëtare;
4. Diploma e studimeve bachelor dhe lista e notave;
5. Deklarata e qëllimit;
6. Rezultati i testit të anglishtes (i detyrueshëm).

Afati i aplikimit të bursave: 1 prill 2024

Afati i vonë i aplikimit: 1 korrik 2024.

SUKSESE!